



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 06 Mars 2022

Nr: 13

**VENDIM**

**PËR**

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 07, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 05.03.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	Bele	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Demokratike, përfaqësuar nga avokati z. Marash Logu

**OBJEKT:** Kundërshtimin e vendimit nr. 171, datë 05.03.2022, të KZAZ-së nr. 26

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



## VËREN:

Partia Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 07 regj., datë 05.03.2022.

Në mbledhjen e datës 06.03.2022, ora 00:30, pas relativitetit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 07 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 06, datë 05.03.2022, të paraqitur nga Partia Demokratike;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 6 Mars 2022, në orën 01:00;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

